

### Drejtuar:

Komisionit Recenzues në përbërje: Prof.dr.Hysen Heta (Kryetar), Prof.dr.Arben Beqiri (Anëtar) dhe Prof.dr.Sadi Bexheti (Anëtar) të formuar në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës, nr.22-802/1 të datës 02.05.2017 lidhur me Konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në thirrje mësimore-shkencore, të shpallur në Buletinin nr 128 të Universitetit të Tetovës të shpallur në web-faqen e Universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) (file:///D:/user/Downloads/buletin128.pdf) më datë 26.03.2018 dhe publik duke filluar nga 26.03.2018 deri më 09.04.2018.

**Nga Prim.Dr.Sci.Med.Dr. Bajram Kamberi**

## ANKESË

### Objekti i ankesës:

1.Referati për zgjedhjen/rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndën Mjekësi urgjente në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në bazë të pasqyrës (dokumentacioni i parashtruar nga ana e kandidatëve Kastriot Haxhirexha dhe Bajram Kamberi) të prezantuar në Buletinin nr 128 të Universitetit të Tetovës të shpallur në web-faqen e Universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) (file:///D:/user/Downloads/buletin128.pdf) më datë 26.03.2018 si dhe të dhënat në Shtojcë të vlerësuara nga komisioni recenzues për raport recenzionin drejtuar Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në thirrje mësimore-shkencore në Fakultetin e Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës për lëndën Mjekësi urgjente.

### Disa tregues si bëhet vlerësimi:

- 1.Vlerësimi në veprimtaritë mësimore-arsimore te kandidati Bajram Kamberi nis jo me mbajtjen e ushtrimeve dhe ligjeratave nga viti akademik 2003/2004 dhe jo në bazë të kontributit në të gjitha lëndët mësimore (Neurologji, Geriatri, Puna klinike te personat me senzore të dëmtuar dhe Akupunkturë).
- 2.Methodologjia e vlerësimit në veprimtaritë shkencore-hulumtuese nuk bazohet mbi baza të njëjta në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale të bashkëpunëtorit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës (teza të mbrojtura të magjistraturës dhe doktoraturës maten me një sistem pikëzimi të ndryshëm nga performancë më të lartë 10 te kandidati Kastriot Haxhirexha deri tek ata më të ulët 4 te kandidati Bajram Kamberi).
- 3.Lista e artikujve të botuar në revista kombëtare apo ndërkombëtare shkencore/profesionale sipas kriterëve të përcaktuara nuk grupohen sipas nënfushave kryesore dhe administrohet në të gjithë procesin e vlerësimit pa ndjek kriteret të përcaktuara dhe në fund publikohet një rënditje jo adekuate në bazë të pikave. Për shembull: Kastriot Haxhirexha, Skender Shabani, Imri Vishi, Ferizat Haxhirexha. „Kosova Jurnal of Surgery- Shtator 2003 Vellimi 1 Numri 1: “ Anomalite anorektale” **2 pikë**; Kastriot Haxhirexha, et al. MEDICUS - Revista e shoqates se mjekeve Shqiptar ne Maqedoni Vol XVI (2). Dhjetor 2011: Fistula salpingo-kutane pas apendektomise **2x0.9=1.8 pikë**.
- 4.Te kandidati Bajram Kamberi mungon vlerësimi i aktivitetit në projekte kombëtare („Mutacionet gjenetike të lidhura me sëmundjet e enëve të gjakut në Republikën e Maqedonisë”; Pjesëmarrje në projekt për menaxhimin e sektorit shëndetësor në kuadër të „Programit të akredituar

për trajnim për edukator, pyetës dhe mentor për modernizim të procesit për çertifikim të mjekëve, stomatologëve dhe farmacistëve në Republikën e Maqedonisë” nga 24-28 shtator të vitit 2006, ku trajnues ishin profesorë eminent: XhudiMekim dhe AnitaAndervud, Shkup; Pjesëmarrje në projekt të ministrisë së shëndetësisë në Republikën e Maqedonisë për hartimin e “Udhëzuesve për praktikim të medicinës së bazuar në fakte”, viti 2002, Shkup, si anëtar i grupit të punës për neurologji ) dhe projekt ndërkombëtar („Hulumtim multinacional, multicentrik, i randomizuar, i kontrolluar-placebo në grupe paralele te subjektët me formë remitente-relapse të sklerozës multiple (RRMS) për vlerësim të efikasitetit, siguris dhe tolerimit në formulimin e ri të glatiramer acetatit (GA) 20mg/0,5ml të pranuar çdo ditë si injeksion nën lëkurë (PI)”) etj., si dhe vlerësimi i aktivitetit në veprimtaritë profesionale-aplikative (për shembull: metodat e zbatuara për herë të parë në institucion- neurologjia urgjente; diagnostikim të aksidentit vaskular cerebral iskemik dhe përdorim të trombolizës; dupleks sonografia ekstrakraniale në neurologji) etj.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme si dhe nga të dhënat tjera për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatëve që kanë konkuruar të prezantuar në Buletinin nr 128 të Universitetit të Tetovës të shpallur në web-faqen e Universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) (file:///D:/user/Downloads/buletin128.pdf) më datë 26.03.2018 kam nderin Komisionit Recenzues në përbërje: Prof.dr.Hysen Heta (Kryetar), Prof.dr.Arben Beqiri (Anëtar) dhe Prof.dr.Sadi Bexheti (Anëtar) t'i propozojë **RIVLERËSIM** të fakteve rreth të cilave bëhet ankesa dhe të dhënave të tjera në Shtojcë të (jo)vlerësuar për raport recenzionin drejtuar Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në thirrje mësimore-shkencore në Fakultetin e Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës për lëndën Mjekësi urgjente.  
Me respekt!

Data: 06.04.2018

Ankuesi: Prim.Dr.Sci.Med.Dr. Bajram Kamberi